

VENDIM
Nr.832, datë 28.12.2005

**PËR DHËNIEN E NJË SHPËRBLIMI TË MENJËHERSHËM, SI NDIHMË PËR FESTIMIN
E VITIT TË RI, NËNAVE ME TRE APO MË SHUMË FËMIJË, TË LINDUR NJËHERËSH,
TË CILËT NUK KANË FILLUAR ARSIMIN E DETYRUESHËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të nenit 21 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 7 e 10 të ligjit nr. 9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Dhënien e një shpërblimi të menjëhershëm, si ndihmë për festimin e Vitit të Ri, në masën 5000 (pesë mijë) lekë, për çdo fëmijë, nënave me tre apo më shumë fëmijë, të lindur njëherësh, të cilët nuk kanë filluar arsimin e detyrueshëm.

2. Fondi prej 1 000 000(një milion) lekësh, i llogaritur për zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha